

NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA

BASHKIA TIRANË FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dea-N Consulting Studio” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk & Florian Shima

Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 1, Rr: ‘Ali Demi’, Kompleksi Vind, Shkalla D, Kati 6, Ap. 34, Tiranë

Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit

“Aktekspertizë e thelluar për objektet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, të klasifikuara sipas shkallës së dëmtimit DS 4 dhe DS 5, në Njësinë Administrative Nr. 5”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: Nuk ka.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Procedurë me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës (në rrugë shkresore) e zhvilluar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 26, datë 15.01.2020 “Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara“, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 10.01.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Bashkinë Tiranë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”, Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” si dhe mbështetur në ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), Kreu III, neni 33, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, (i ndryshuar), neni 36, pika 2. Kohëzgjatja e kontratës është 56 (pesëdhjetë e gjashtë) ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Fondi limit: 2,875,833.33 (dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, miratuar me VKB Nr. 2, datë 05.02.2020 “Për një shtesë dhe ndryshim në Venimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 157, datë 26.12.2019, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”.

Publikime të mëparshme: Nuk ka.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dea-N Consulting Studio” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk & Florian Shima, NUIS L11511002I, NUIS K47103804L, NUIS K91628001D.

Çmimi total i ofertës pa TVSH: 2,870,000 (dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 3,444,000 (tre milion e katërqind e dyzetë e katër mijë) lekë.

1. Operatori Ekonomik “ER-NO” Shpk, NUIS L72023002P

Çmimi total i ofertës pa TVSH: 2,875,800 (dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 3,450,960 (tre milion e katërqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

Operator i s’kualifikuar, prkatesisht per arsyet e meposhte:

1. Operatorit Ekonomik “ER-NO” Shpk

- Operatori ekonomik “ER-NO” shpk nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet kete te punesuar per kryejen e te gjitha sherbimeve ne objekt, te perfshire ne Licensen e shoqerise ose pajisur me license individuale, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme per stafin inxhinierik si me poshte...” pasi nuk është paraqitur dokumentacion i plotë për të gjithë stafin e kërkuar.
- Operatori ekonomik “ER-NO” shpk nuk plotëson pikën 5-8 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit pasi nuk janë paraqitur Çertifikata ISO.
- Operatori ekonomik “ER-NO” shpk nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit ekonomik të Dokumentave Standarte të Tenderit pasi nuk është paraqitur vertetim per taksat e viti 2020.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Dea-N Consulting Studio” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk & Florian Shimame adresë kryesore Adresa Njesia Bashkiake Nr. 1, Rr: ‘Ali Demi’, Kompleksi Vind, Shkalla D, Kati 6, Ap. 34, Tiranë, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme Çmimi total i ofertës pa TVSH: 2,870,000 (dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH: 3,444,000 (tre milion e katërqind e dyzetë e katër mijë) lekë lekë, me afat të realizimit 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, është ofertë fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, menjehere me marrjen e këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.09.2020